



# Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Data: 01.03.2017

Ref.: 130/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 48-të, të mbajtur më 23 shkurt 2017, mori:

## V E N D I M

- I. REFUZOHET kërkesa nr.648/16, dt. 07.11.2016 e BPrAL Kolegji “Heimerer” për ri/akreditim të programeve të studimit:
  - Menaxhimi i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore, MSc (120 ECTS);
  - Fizioterapi, BSc (180 ECTS);
  - Infermieri, BSc (180 ECTS), Dega në Gjakovë
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

BPrAL Kolegji “Heimerer” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim të programeve të studimit: Menaxhimi i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore, MSc (120 ECTS); Fizioterapi, BSc (180 ECTS); Infermieri, BSc (180 ECTS), Dega në Gjakovë.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2017 ka vlerësuar aplikacionin e BPrAL Kolegji “Heimerer”, dhe pas shqyrtimit të dosjeve të stafit akademik duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (nr.20/2016, datë 20.09.2016), neni 11, pika 3.2, ku sipas kësaj pike, institucioni duhet të ketë të paktën tre PhD (Dr.sc.) në marrëdhënie të rregullt pune për secilin program studimi, dhe në pajtim me nenin 13, pika 1.1 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, KSHC ka konstatuar që ky aplikacion nuk i përmbush kushtet për aprovim, dhe më këtë rast ka refuzuar aprovimin e aplikacionit të BPrAL Kolegji “Heimerer” për programet e cekura në dispozitiv.

Sa i përket kërkesës për hapjen e degës në Gjakovë me program të studimit Infermieri, BSc (180 ECTS), BPrAL Kolegji “Heimerer” ka vendosur si bartës të programit të studimit tre persona ku njëri nga ta nuk ka marrëdhënie të rregullt të punës në këtë institucion. Pavarësisht që me UA për Akreditim nuk nevojiten 3

PhD, institucioni duhet të ketë staf të rregullt për programin e studimit, andaj për këtë arsye KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të ofruar nga BPrAL Kolegji "Heimerer", KSHC konstatoj se ka mungesë të stafit akademik me dokumentacion të rregullt për këto programe te studimit, dhe si rrjedhojë e kësaj gjendje, KSHC mori vendim për refuzim të aplikacionit.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Heimerer"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

